



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport

Nr.764/2018

Datë: 15.05.2018

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Veton Firzi, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, Rregulloren 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e projekt-propozimeve që janë dorëzuar në shpalljen e me tematik Siguria Njerëzore në Divizionin për Parandalim dhe Integrim Shoqëror në Departamentin e Rinisë në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij vendimi, ka këtë përbërje:
 - 2.1. Labinot Berisha, kryesues;
 - 2.2. Donika Gashi, anëtare;
 - 2.3. Besim Shala, anëtar.
 - 2.4. Gentiana Gashi, përfaqësues i OJQ-ve;
 - 2.5. Arianit Jashari, përfaqësuese i Shoqërisë Civile.
3. Komisioni është i mandatar të bëjë vlerësimin e projekteve të paraqitura në Departamentin e Rinisë, në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara duke përfshirë edhe fazën përfundimtare të shpalljes së përfituesve dhe jo përfituesve nga ky konkurs, duke ndjekur të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve .
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Departamentit Ligjor;
- Departamentit të Rinisë;
- Arkivit të MKRS-së.

